



Kuvendi i Kosovës

KUSHTETUTA JONË



KUSHTETUTA JONË



Kushtetuta e Republikës së Kosovës është miratuar me 9 prill 2008 nga Kuvendi i Kosovës.



Kushtetuta është akti juridik kryesor i vendit tonë.




Të gjitha ligjet në Kosovë duhet të bëhen në përputhje me Kushtetutën.




Të drejtat e fëmijëve në Kosovë garantohen me Kushtetutë dhe ligje vendore, si dhe me konventa ndërkombëtare.



Kuvendi i Kosovës



SHTETI DEMOKRATIK



Kushtetuta jonë e përcakton vendin tonë si shtet demokratik që nënkupton se populli zgjedh përfaqësuesit e tij në Kuvendin e Kosovës.

Nëpërmjet votimeve, qytetarët zgjedhin përfaqësuesit e tyre në Kuvendin e Kosovës, të cilët quhen deputetë.




120 deputetë përfaqësojnë tërë Kosovën në Kuvend. Ata zgjidhen çdo 4 vite dhe çdo kush mbi moshën 18 vjeç mund të garojë për tu zgjedhur.

Kuvendi miraton ligje të cilat duhet t'i respektojmë të gjithë. Një ndër ligjet kryesore që Kuvendi miraton është ai për Buxhetin, nëpërmjet të cilit financohet ndërtimi i rrugëve, spitaleve, shkollave etj.



Kuvendi i Kosovës



KUSHTETUTA GARANTON



Kushtetuta garanton barazinë e të gjithë qytetarëve në Kosovë.

Të gjithë fëmijët në Kosovë kanë të drejtë për shkollim dhe qasje në kujdes shëndetësor.



Fëmijët nuk kanë të drejtë të shfrytëzohen dhe detyrohen për të punuar.

Të respektojmë besimet dhe bindjet e njëri-tjetrit!



Kuvendi i Kosovës

